

BASHKIA MALLAKASTËR



RAPORTI VJETOR PËR VEPRIMTARINE E S&B 2018

PËRMBAJTJA E LËNDËS

I. Përmbledhje Ekzekutive	3-4
II. Baza Ligjore	4
III. Organizimi	4-5
<i>III.1 Misioni i auditimit të brendshëm</i>	<i>4</i>
<i>III.2 Struktura Organike e NJAB</i>	<i>4-5</i>
IV. Rezultatet e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm	5-10
<i>IV.1 Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese.</i>	<i>5</i>
<i>IV.2 Analiza e misioneve të auditimit</i>	<i>5-6</i>
<i>IV.3 Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre.</i>	<i>6-7</i>
<i>IV.4 Gjetjet kryesore sipas sistemeve</i>	<i>7-8</i>
<i>IV.5 Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm</i>	
<i>IV.6 Ceshtjet e dërguara për investigim</i>	
V. Rekomandimet.	8-10
<i>V.1 Rekomandimet e propozuara.</i>	<i>8-9</i>
<i>V.2 Përgjigjja dhe reagimet e menaxhimit.</i>	<i>10</i>
VI. Monitorimi i sistemit dhe sigurisë cilësisë	
VII. Ananliza e kapaciteteve audituesve	
• <i>Probleme të konstatuara në lidhje m funksionimn e NJAB</i>	
• <i>Kapacitetet audituese</i>	
• <i>Zhvillimi i aftësive dhe ngritja e nivelit profesional tëaudituese</i>	
• <i>Analiza e kostove dhe shpërdorja e burimeve</i>	
VIII. Konkluzioneve	
• <i>Konkluzione mbi problematikën e punës audituesve</i>	
• <i>Prioritetet për vitin ardhshëm</i>	

Lista e Pasqyrave bashkangjitur

- Pasqyra 1: Përbërja profesionale dhe niveli i kualifikimit të audituesve të brendshëm
- Pasqyra 2: Realizimi i programit nga **Sektori** i Auditimit të Brendshëm
- Pasqyra 3: Gjetjet të ndara sipas sistemeve nga **Sektorii** Auditimit të Brendshëm
- Pasqyra 4: Rekomandimet e dhëna nga **Sektorii** Auditimit të Brendshëm

Shënim bashkangjitur raportit, ju dërgojmë në një raport të përmbledhur të gjithë memorandumeve për subjektet e audituar dhe të evaduar për vitin 2018

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti vjetor i veprimtarisë të Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Institucionin të bashkisë Mallakastër paraqet strategjinë e programit të auditimit të brendshëm, menaxhimin e burimeve, treguesit dhe matësit e performancës dhe shkallën e pajtueshmërisë me standardet profesionale

Funksioni i Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Institucionin e bashkisë Mallakastër ka mbështetur titullarin e institucionit, për arritjen e objektivave të tyre, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë. E vecanta e veprimtarisë së këtij sektori për vitin 2018 është auditimi për herë të parë i drejtorive dhe sektorve të rinj të Bashkisë Mallakastër krijuar si rezultat i reformës administrative.

Në këtë Raport jepen konkluzionet e përgjithshme të Sektorit të auditimit të brendshëm në Institucionin e bashkisë Mallakastër, mbi çështje të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, menaxhimit të riskut, proceseve të qeverisjes së subjekteve publike etj, duke i nxjerrë vlerësimet të argumentuara dhe të arsyetuara me përshkrimin e procedurave të ndjekura të cilat kanë çuar në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Raporti përshkruan statusin, autoritetin, strukturën organizative dhe burimet e sektorit të auditimit të brendshëm në bashkinë Mallakastër, procesin e planifikimit mbi bazë risku të përdorur gjatë veprimtarisë së auditimit të brendshëm, si dhe pasqyron rezultatet më kryesore të kësaj veprimtarie për vitin 2018.

Sektorit i Auditimit të Brendshëm në Institucionin e Bashkisë Mallakastër ka zhvilluar veprimtarinë e auditimit të brendshëm për vitin 2018 në 1 njësi administrative në 6 drejtorie dhe 4 sektore varësi të kryetarit të bashkisë nga 8 njësi administrative funksionon vetëm njësi Administrative Fratar mbasi mbas datës 31/12/2017 u suprimuan 7 njësi administrative me VKB nr 55 datë 25/12/2017

Analiza e sistemit mbështetet në të dhënat e grumbulluara në Raportet perfundimtare të Auditimit në 1- njësi administrative, në 4 drejtorie, e 1 sektor të bashkisë Mallakastër të evaduar deri 31/12/2018

Për vitin 2018 janë kryer 8 auditime të përbëra nga 2 auditime të përputhshmërisë 1 i performancës, 2 financiar dhe 3 auditime të kombinuar. Janë dhënë rekomandime për mos arkëtim të ardhurash sipas planifikimit nga Sektori pyjeve, sektori PMNZSH nga tarifat e transportit me furgona dhe dhënja e autorizimeve, lejeve të ndërtimit, nga zënja e ambjenteve me qëra. Janë dhënë rekomandime për kontabilizime dhe arkëtimin e debitorve të biznesit madh dhe të vogël lekë 20492 mijë lekë të tokës me qëra 1803 mijë lekë për debitorët e ujit të pishëm 36000 mijë lekë për debit/kreditë deri në 31/12/2018 kemi debitorë 58526 mijë lekë dhe kreditorë 13974 mijë lekë.

Nga auditimet e kryera janë konstatuar raste të shkeljeve financiare e ligjore me dem ekonomik në vlerë 5085 mijë lekë për 4 subjekte .

Për çdo rast të shkeljeve të konstatuara janë përcaktuar përgjegjësitë gjë që ka mundësuar që rekomandimet të adresohen gjithnjë e më mirë, të jenë të zbatueshme dhe efektive për subjektet e audituara. Theksojmë se janë gjithsej 69 rekomandime, të ndara në: 12 rekomandimi përmirësimi sistemi 18 rekomandimi përmirësimi kuadrit ligjor, 16 rekomandime për arkëtime për arkëtime 15 rekomandime organizative dhe 8 rekomandime të tjera

II. KUADRI LIGJOR BAZË DHE MBËSHTETËS

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Institucionit e Bashkisë Mallakastër, për vitin 2018 si bazë për të ushtruar funksionet e tij është mbështetur në kërkesat e ligjin nr.9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” ndryshuar me ligjin nr 114 datë 22/10/2015, ligji 8652 datë 31/07/2000”për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendor,ligjinr 139 datë 17/12/2015”për vetëqeverisjen vendore” në Urdhërin e Ministrit të financave Nr.100, datë 25/10/2016 “Për Miratimin e Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Akte të tjera nënligjore, të cilat janë pjesë e paketës ligjore për rregullimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm janë si më poshtë:

Gjithashtu Sektori i Auditimit të Brendshëm,ka përgatitur kartën dhe manualin e Auditit të brendshëm të Bashkisë Mallakastër dhe në fillim të vitit cdo auditim ka dhënë deklaratën e objektivitetit,paansisë dhe kopetencës.

III. ORGANIZIMI I SAB

III.1 Misioni dhe objektivat e sektorit të auditimit të brendshëm

Misioni Sektorit të auditimit të brendshëm në Institucionin e bashkisë Mallakastër ,është të mbështesë menaxhimin e lartë për kryerjen e përgjegjësi të tyre dhe konkretisht:

1. Të ndihmojë subjektet e sektorit publik për të qenë të përgjegjshëm ndaj publikut, duke vlerësuar zbatimin e ligjit, rregulloreve dhe kontrolleve të vendosura, si dhe duke siguruar dobinë, frytshmërinë dhe kursimin e veprimeve;
2. Të japë siguri objektive tek organet mbikëqyrëse/titullarët, mbi saktësinë dhe besueshmërinë e raporteve financiare dhe raporteve të performancës, të përgatitura nga strukturat e menaxhimit;
3. Të ndihmojë menaxhimin e sektorit publik në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të tyre, duke përmirësuar sistemet dhe shërbimet e njësisë;
4. Të minimizojë mundësitë për mashtrim, shpërdorim dhe abuzim; dhe
5. Të ndihmojë punonjësit në përmirësimin e performancës së përgjithshme

III.2 Struktura Organike e sektorit të auditimit të brendshëm

Struktura organike e Njësisë të Auditit të Brendshëm, është e ndërtuar në bazë sektori ku, në bazë te strukturës organike të bashkisë Mallakatër , në fund të vitit 2018në SAB Ballsh, sipas organikes të miratuara duhen punësohen 3 auditues nga të cilët 1 përgjegjës dhe aktualisht janë të punësuar 3 auditues të brendshëm janë kualifikuar dhe certifikuar për këtë fushë 2 auditues,dhe 1 specialist u certifikua gjatë viteve 2017-2018. Sektori është krijuar me 1/10/2015 me 2 auditues deri në 31/5/2018

Me konkretisht në tabelën më poshtë është Struktura organike e Njësisë të Auditit të Brendshëm.

Tabela nr.1 Struktura organike e Njësisë të Auditit të Brendshëm për vitin2018

	Emër Mbiemër	Pozicioni	Profesioni sipas Arsimimit Bazë	Vite pune ne Auditim	Vite pune
1	Dervish Baraj	Pergj.Sektori	Ekonomist kontabël industrial	25	Mbi 25
2	Anisa Ballaj	Inspektor Auditit	Financë kontabilitet	11	11
3	Valdete Saliq	Specialiste Auditit	Financë -Kontablitet	2	7

Një nga punonjësit është certifikuar ne baze kërkesave te Ligjit Nr.9009 date 13.02.2003 “Për Auditimin e brendshëm ne sektorin publik” ne vitin 2005 një punonjës është certifikuar ne vitin 2010 baze te Ligjit Nr.9720 datë 23.04.2007 “Për Auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar ne vitin 2010 dhe një punonjës është certifikuar për vitin 2018 në bazë të kërkesave të ligjit nr 114 datë 22/10/2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”

IV. REZULTATET E VEPRIMTARISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

IV.1 Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese.

Planifikimi i misioneve të plota & tematike të auditimit, për vitin 2018 janë bërë në bazë të programit strategjik për vitin 2018-2020 dhe planit vjetor të vitit 2018 të miratuar nga kryetari i bashkisë Mallakastër Z.Agron Kapllanaj me shkresë nr 08 datë 05/01/2018

Rezultatet e punës për cdo auditim raportohen në mënyrë periodike dhe memorndume per titullari bashkisë të cilat kanë si qëllim dhënien e informacionit mbi situatën e zhvillimit të sistemit të auditimit të brendshëm, raportimin e gjetjeve, përgjithësimin e rezultateve te rekomandimet e dhëna, e të pranuar nga subjekti si dhe rekomandimet e pa pranuar

IV.2 Analiza e misioneve të auditimit

Në analizën që i është bërë misioneve të auditimit sipas llojeve janë vërejtur shmangie të realizimit të programeve nga ato të planifikuara si pasojë e përfundimeve të auditimeve në ish komunat dhe fillimi procesit misioneve të auditimeve për drejtoritë e sektorët e Bashkisë që kanë kryer aktivitet pune mbi një vitë.

Sipas planit duhej audituar 9 subjekte efektivisht janë audituar 8 subjekte. Është audituar zbatimi i rekomandimeve në 14 subjekte të audituara nga 01/10/2015 në 14 subjekte të audituara nga 01/10/2015i në 31/12/2017. Gjatë periudhës janar-mars 2018 audituesit kanë qënë me grupin e Audituesve të KLSH për auditimin e Bashkisë Mallakastër.

Auditimet të kombinuara e plota nga janë realizuar në 3 objekte dhe konkretisht Sektori i PMNZSH, Drejtoria e Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike, Ujësjells Kanalizime Mallakastër. Jane kryer 2 auditime të përputhshmërisë në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe në Sektorin e Inspektoriatit Mbrojtjes së Territorit, 1 auditim performance në Setorin e Tatim Taksave, 2 auditime financiare në Sektorin e tatim taksave dhe Sektorin e finances kreditoret dhe debitoret.

Nga 8 subjekte te audituara janë evaduar 7 dhe janë ne proçes evadimi 1 auditim dhe konkretisht Drejtoria e Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike.

Duke iu referuar të dhënave të raportuara realizimi i auditimeve në total dhe sipas llojeve paraqiten në tabelën e mëposhtme: pasqyra 2

Tab.3 Realizimi i auditimeve sipas llojit për vitin 2018

Realizimi i planit të angazhimeve për vitin 2018

**Në
numër**

Nr	Subjekte të audituara ngs NJAB	Realizimi i angazhimeve të auditimit									
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre								Statusi i Angazhimit	
		Gjithsej	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shërbime Këshillimi	Angazhime me kërkesë të titullarit	Angazhime të përfunduara	Angazhime në proces
			A. të përputhshmërisë	A. të performancës	A. financiare	A. tek. Informacionit	A. të kombinuara				
a.	1	(3.1+3.2+3.3+3.4+3.5+3.6+3.7) ose (4.1+4.2)	3,1	3,2	3,3	3,4	3,5	3,6	3,7	4,1	4,2
1	Sektori PMNZSH-se	1					1			1	
2	Drejtoria e Plnanifikimit te Territorit	1	1							1	
3	Ujesjells Kanalizime ShA	1					1			1	
4	Sektori Tatim Taksave	2		1	1					2	
5	Analiza e kreditorve e ditorve,Sektori Financës	1			1					1	
6	Inspektoriati Mbrojtjes se Territorit	1	1							1	
7	Drejtoria e Infrastruktures dhe Sherbimeve Publike	1					1				1
8											
9											
Totali		8	2	1	2	0	3	0	0	7	1

Në Zbatim të shkresës nr 1332 datë 08/01/2017 nga Ministria e Financave,gjatë vitit 2018 u auditua dokumentimi dhe likujdimi debi,kredive të ardhura nga ish komunat e të krijuara nga Bashkija gjatë vitit 2015.Auditusit kanë marrë pjesë në dy komisione hetimore për zbatimin e detyrave të KLSH-së

IV.3 Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre.

Në Planet Strategjike dhe Vjetore të SAB, janë identifikuar dhe vlerësuar risqet kryesore për veprimtarinë e subjekte publike mbështetur në Ligjin për Auditimin e Brendshëm dhe Manualin e Procedurave duke programuar dhe auditimin e fushave dhe subjekteve që paraqiten me një nivel të lartë risku. Përcaktimi i nivelit të riskut është bërë duke marrë në konsideratë faktorët e riskut ku ndër më kryesorët kanë qenë si më poshtë:

Kompleksiteti i subjekteve;

Mjedisi i kontrollit;

Shkalla e ndryshimeve organizative dhe të menaxhimit;

Madhësia apo volumi i transaksioneve me vlera monetare;

Çështje ndaj të cilave ka interes të lartë publik dhe qeveritar;

Risku i brendshëm i fushës apo subjektit që auditohet;

Koha apo periudha e auditime në të kaluarën.

Bazuar në faktorët e mësipërm, janë vlerësuar me risk më të lartë sistemet në vijim:

- **Sisteme të tjera sipas qëllimit** dhe misioneve të veçanta të institucioneve konsiderohet si fusha me risk të mesëm në mënyrë të veçantë për zbatueshmërinë korrekt të procedurave ligjore të kërkuara për detyrimet nr. nga taksat dhe tarifaf vendore nga subjektet tregtare dhe nga popullata, cilat përfshijnë dhe 60% të gjetjeve të AB.
- **Sistemi i Kontabilitetit dhe Raportimit financiar** është vlerësuar me risk të mesëm por si rezultat i rivlerësimit të riskut si rezultat i reformës teritorjale për vlerësimin e pasurive dhe gjendjen e debitorëve të ish-komunës,
- **Sistemi i pagesave për personelin** është vlerësuar me risk të lartë dhe në të dhënat e Pasqyrës Nr.4, bashkangjitur këtij raporti “Gjetje sipas sistemeve”, rezulton me risk të lartë .
- **Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit** është vlerësuar me risk të mesëm dhe në të dhënat e Pasqyrës Nr.4, bashkangjitur këtij raporti “Gjetje sipas sistemeve”, rezulton me risk të mesëm dhe përfshijnë 7% të gjetjeve të AB
- **Sistemi i Prokurimeve publike** është vlerësuar me risk të lartë dhe në të dhënat e Pasqyrës Nr 4, bashkangjitur këtij raporti “Gjetje sipas sistemeve”, rezulton me risk të mesëm dhe përfshijnë 24% të gjetjeve të AB
- **Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore** është vlerësuar me risk të ulët dhe në të dhënat e Pasqyrës Nr.3, bashkangjitur këtij raporti “Gjetje sipas sistemeve” me dëm ekonomik , paraqitet me risk të ulët.

Përcaktimi i fushave me risk të lartë bëhet që në fazën e planifikimit të veprimtarisë për vitin pasardhës. Megjithatë, si rezultat i rivlerësimit të riskut gjatë vitit dhe kur menaxhimi e gjykon të arsyeshme, për fusha të cilat risku në situata të veçanta paraqitet më i lartë se vlerësimi në Planin Vjetor, janë kryer misionet auditimi me urdhër të veçantë të titullarit duke i kushtuar vëmendje procesit të ndjekjes së rekomandimeve për parandalimin në përsëritjen e shkeljeve financiare e ligjore me dem ekonomik në të ardhmen.

IV.5 Gjetjet kryesore sipas sistemeve dhe vlerësimi i kontrollit të brendshëm

Gjetjet kryesore të rezultuara veprimtaria e SAB për vitin 2018 lidhen kryesisht me mosfunksionim siç duhet të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në fushën e investimeve publike, në fushën e prokurimeve, sistemin e pagave në realizimin e të ardhurave në proceset organizative ku më kryesorët përmendim:

- Shkelje janë konstatuar në Sisteme të tjera sipas qëllimit dhe misioneve të veçanta të institucioneve dhe në mënyrë të veçantë për zbatueshmërinë korrekt të procedurave ligjore të kërkuara për detyrimet nr. nga taksat dhe tarifaf vendore nga subjektet tregtare dhe nga popullata

- Shkelje janë konstatuar në sistemet e kontabilitetit dhe raportimit financiar, të cilat konsistojnë kryesisht menaxhimin dhe ruajtjen dhe administrimin e aktive dhe pasqyrimi i aktiveve në dhënjen e pronës me qëra, në mos aplikimin e saktë të tatimit mbi të ardhurat
- Shkelje janë konstatuar Sistemi e Prokurimeve të cilat konsistojnë kryesisht në dokumentimin e procedurave të blerjes , pagesa për punime ndërtimi jashtë licencës etj. punime të pakryera.

Të dhënat numerike mbi rastet e konstatuara të shkeljeve si dhe ndikimi financiar që ato kanë pasur në buxhetin e subjekteve të audituara janë paraqitur në Pasqyrën 3, bashkangjitur këtij raporti Në mënyre të përmbledhur rezultojnë :

1. Gjetje në fushën e prokurimeve blerjeve të vogla 30 mijë lekë
 2. Gjetje në sistemin e pagave, shpërblime, trajtnime 767 mijë lekë
 3. Gjetje në fushën e sigurimeve shoqërore, shëndetësore 0 lekë
 4. Gjetje në sistemin e tatim taksave 2658 mijëlekë
 5. Gjetje në fushën e pronësisë dhe pronës (dhënia me qera) 1132 mijë lekë
 6. Gjetje në sisteme të tjera , buxheti , kontabiliteti i inventarëve, deklaratat financiare 525 mije
- Totali i gjetjeve nga auditimi 5085 mijë lekë

IV.6 Cështje të dërguara për investigim

Nuk janë konstatuar raste të shkeljeve të tilla për tu investiguar

V. REKOMANDIMET.

V.1 Rekomandimet e propozuara.

Për shkeljet e konstatuara, me dem dhe pa dem ekonomik, janë rekomanduar edhe masat si më poshtë;

Është kërkuar ç dëmtim i plotë për shkeljet financiare ne shumën **5085 mijë lekë** të dokumentuara në Raportet përfundimtare, plan veprimet dhe në memorandumet e dërguara menaxhimit të lartë

Sipas te dhënave te Pasqyrës nr. 5: *Rekomandimet e dhëna nga Sektori i Auditimit të Brendshëm për vitin 2018*”, bashkangjitur raportit, janë rekomanduar masa organizative, ç dëmtimi, administrative gjithsej 123 rekomandime te ndara në

- Rekomandime për përmirësim sistemi dhënë 12 pranuar 12 zbatuar 12
- Rekomandime për përmirësimi kuadri ligjor dhënë 18 pranuar 15 zbatuar 7 në proces 8

- Rekomandime për me karakter organizativë dhënë 15 pranuar 16 zbatuar 15
- Rekomandime për arkëtim dhënë 16 pranuar 13 në proces 13
- Rekomandime të tjera dhene 8 pranuar 8 zbatuar 3 në proces 5
- **Gjithsej rekomandime 69**

Nga 69 rekomandim janë pranuar 63, zbatuar 37, në proces zbatimi 26 pa pranuar nga manaxhimi 10

Janë dhëne rekomandime për arkëtimin e detyrimeve nga taksa e tokës bujqësore për vitet 2013-2016 për subjektet debitore , te cilat nuk janë përfshire ne pasqyrën e zbulimeve. Këto rekomandime janë përfshire dhe për detyrimet për debitor taksa biznesi, transporti, qira kullote tarifa për shërbime zjarrfikse , vendosje telefonisë fikse dhe celulare

VI monitorimi i sistemit dhe sigurisë cilësisë

Monitorimi i brendshëm i sigurisë cilësisë është bërë nëpërmjet plotësimit të pyetsorit nga Përgjegjësi i Sektorit për cdo auditim të përfunduar. Për vitin 2019 do të programohet me program të vecantë.

Monitorimi i jashtëm i sigurisë cilësisë është bërë nga klsh për muajn Janar shkurt 2016 rekomandime e dhëna për sektorin e auditimit janë realizuar

VII Analiza e kapaciteteve të audituesve

Të dhënat për strukturën e auditimit certifikimit, trajnimet janë trajtuar në pasqyrën nr 1 kapitullin III.2 :struktura organike e NJAB ku del se struktura është plotësuar dy auditues janë certifikuar i treti vazhdon certifikimin.

VIII konkluzione

Konkluzionet dhe problematikat e konstatuara gjatë punës audituese në mënyrë të përmbledhur janë të përshkruara në përmbledhjen ekzistuese dhe në cdo kapitull të këtij raporti

Prioritete dhe objektivat e SAB për periudhën e vitin 2019 do të fokusohen në vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të riskut dhe proceseve të qeverisjes dhe konkretisht:

1. Kryerja e veprimtarive të auditimit të brendshëm, të cilat kanë qëllim të vlerësojnë se sistemet e kontrollit të brendshëm dhe të menaxhimit financiar, si dhe performanca në subjektin publik të audituar janë transparente, përputhen me normat e ligjshmërisë, të rregullshmërisë, efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomisë.
2. Kryerja e angazhimeve të auditimit të brendshëm, sipas udhëzimeve dhe metodave të miratuara nga Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, për të vlerësuar nëse sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, si dhe performanca e njësisë së audituar janë transparente dhe në përputhje me normat e ligjshmërisë, të rregullshmërisë, të ekonomisë, efektivitetit dhe efikasitetit.”
3. Ndjekja dhe raportimi periodikisht për gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet, që rezultojnë nga veprimtaritë e tyre nr., si dhe dhënia e informacionit për Drejtorinë e Përgjithshme të Auditimit, për rekomandimet e pazbatuara nga drejtuesit e subjektit publik të audituar e për pasojat e moszbatimit të tyre.
4. Përgatitja e raporteve periodike dhe vjetore dhe dërgimi i tyre në Drejtorinë e Përgjithshme të Auditimit, sipas afateve dhe kërkesave të përcaktuara prej saj dhe të miratuara nga Ministri i Financave. Raportet përmbledhëse, në të gjitha rastet, duhet të shoqërohen me evidencat e raportimit për periudhën raportuese, në mënyrë progresive dhe një vlerësim përmblyës për veprimtarinë nr. për këtë periudhë.
5. Përfundimet për funksionimin e sistemeve të kontrollit brenda njësisë publike, së bashku me rekomandimet për përmirësim
6. Raportimi, pas këshillimit me strukturën përkatëse juridike, te drejtuesi i subjektit publik të audituar dhe i njësisë së inspektimit, kur zbulon parregullsi apo veprime që përbëjnë vepër penale.
7. Raportimi tek Drejtusi i Bashkisë Mallakastër i rezultateve të kontrollit të cilësisë të materialeve të Auditimit.

V.2 Përgjegjja dhe reagimet e menaxhimit.

U është rekomanduar subjekteve të audituara dhe menaxhimi të lartëqë për shkeljet e procedurave të mëposhtëmë

Te dale përgjegjësia ndaj personave përgjegjë.

Disa nga keto mangesi janë:

- për shkeljen e procedurave si për programimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, ne mos llogaritjen e sakte të nivelit të taksave dhe tarifave vendore
- për funksionimi i plote i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore
- për programimin dhe përdorimin e fondeve buxhetore dhe të ardhurave të veta, të për kryerjen e pagesave dhe shpërblimeve jashtë strukturave dhe niveleve të përcaktuara
- për mos funksionimin e plote të sistemit të prokurimeve publike, për blerje në vlera të vogla,
- për zbatimin e kontratave, pasaktësia në sistemin e kontabilitetit të inventarëve të pasurisë, mungesa në inventarët ekonomik mos magazinimipjesëve të këmbimit mos dokumentimi në disa raste i përdorimit materialeve inerte dhe karburantit
- për moszbatimin e rregullave në disa raste të qarkullimit të mjeteve monetare nëpërmjet arkës,.

Një pjesë e akt konstatimeve dhe akt verifikimeve janë observuar nga subjektet dhe janë dërguar së bashku me projekt-raportin në raportin përfundimtarë. Nga ana e grupeve të auditimit pjesërisht janë marrë parasysh këto rekomandime duke dhënë përgjigjet ligjore dhe nuk janë lenë për zbatim në planin e veprimit.

Materialet e auditimit dhe masat e propozuara janë mbështetur nga kryetari i bashksë Mallakastër duke u kërkuar subjekteve të audituara që rekomandimet e dhëna të zbatohen prej tyre.

Përgjegjësi i SAB
Dervish BARAJ